



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:264809 C. nr. 3849/2023  
Datë: 06.02.2025  
Numri i dokumentit: 06813034

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me zyrtaren ligjore D.Ç. në çështjen juridike kontestuese të iniciuar me padi nga ana e paditësit E.E. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H. Avokat nga Prishtina kundër të paditurës; M.A.Sh.T. me seli në Prishtinë me objekt kontesti kompensim i shujtave ditore, vlera e kontestit 306 Euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 06 Shkurt 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

MIRATOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses.

Detyrohet e paditura M.A.Sh.T. që paditëses E.E. nga Prizreni, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për vitin 2022, për gjithsej 153 ditë pune, t'ia kompensoj shumën prej 306,00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 02.12.2023, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë të gjitha shpenzimet procedurale në shumë prej 124.00 (njëqind e njëzetë e katër) euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja E.E. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj Av. A.H. nga Prishtina, në këtë Gjykatë me datën 02.12.2023 ka parashtruar padi për kompensimin e shujtave ditore, kundër të paditurës M.A.Sh.T. me vlerë të kontestit 306.00 Euro.

Në padi, e autorizuara e paditëses ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune si mësimdhënëse në Q.B.M.K. "Lef Nosi" në Prizren. Në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të vitit 2021 e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021 këtu paditëses, e paditura ishte e obliguar që për prezencën në punë t'ia paguajë nga dy (2) euro në ditë në emër të kompensimit për ushqim në punë dhe atë gjatë vitit 2022 ka punuar 153ditë dhe punëdhënësi M.A.Sh.T. dhe Inovacionit me seli në Prishtinë ishte e obliguar që të ia kompensojë mjetet në shumë prej 306.00 Euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore 20.00 euro apo në total shumën prej 124.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se duke u bazuar në njoftimin e M.A.Sh.T. dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022 për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2022 padia dhe kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar. Ka theksuar se paditësja nuk kanë ofruar prova që janë anëtarë të sindikatës dhe i kanë kaluar procedurat administrative sepse nuk i kanë vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i kanë shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative,. Gjithashtu ka theksuar se pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast M.A.Sh.T. dhe Inovacionit nuk është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, duke i bashkangjitur faktin se e njëjta nga data 21.11.2022 është tërhequr nga nga Kontrata kolektive e arsimit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune në Q.B.M.K. “Lef Nosi” në Prizren te e paditura, respektivisht M.A.Sh.T. dhe Inovacionit e cila bie në kompetencë të paditurës.

Nga vërtetimi me numër të referencës 79 e datës 16.10.2023, e lëshuar nga Drejtori i, Q.B.M.K. “Lef Nosi” në Prizren gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja E.E. nga Prizreni prej datës 03.01.2022 deri më 21.11.2022 ka qenë prezent në punë 153 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimin e lëshuar nga ana e Q.B.M.K. “Lef Nosi” në Prizren si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditëses, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Arsimit të Kosovës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë është paraparë se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si mësimdhënës t'ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par. 1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht, ditët e punës për paditësen, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për 153 ditë pune, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 €, duke ia njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditëses ishte qartazi e themeltë pasi që ka bazë në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 02.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20.00 euro, gjithsej shumën prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C.nr.3849/23, me datë 06 Shkurt 2025

Zyrtare ligjore:  
Drita Çollaku

Gjyqtari  
Atdhe Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.